



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC

Nr. 83 / Prot.

Pogradec, më 02.04.2025

VENDIM

Nr. 73, datë 02.04.2025

PËR CAKTIMIN E VËNDEVE PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE  
PROPAGANDISTIKE GJATË FUSHATËS ELEKTORALE

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 Per Vetëqeverisjen Vendore, nenit 79 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë ” i ndryshuar, nenit 3 për “ Caktimin e vendeve për afishimin e materialeve propagandistike, të Udhëzimit Nr 6 datë 23.03.2021 “ Për Përdorimin e Materialeve Propagandistike e Edukuese dhe Rregullat Për Afishimin e Tyre Gjatë Fushatës Zgjedhore ”

VENDOSA:

1. Subjektet zgjedhore të afishojnë materialet e tyre propagandistike në një largësi prej 5 ( pesë ) metrash nga zyrat e tyre zgjedhore, apo subjekti zgjedhor, dhe jo më pare së 35 ( tridhjetë e pesë ) ditë para datës së zgjedhjeve.
2. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit
3. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në mjete që opërojnë në transportin publik.
4. Vendet e caktuara duhet të jenë në mjedise që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftushme që të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të mund të paraqesin materialet propagandistike, programet e tyre zgjedhore dhe/ ose mesazhet zgjedhore.
5. Subjekteve zgjedhore iu lejohet të afishojnë materialet propagandistike vetëm në vendet e përcaktuara nga Kryetari Bashkisë, sipas këtij neni, dhe marrin masa për heqjen e tyre me përfundimin e fushatës zgjedhore.
6. Vendi i përcaktuar për afishimin e materialeve propagandistike do të jetë tek ndërtesa e Teatri i Kukullave , faqja anësore nga ana jugore e ndërtesës si dhe tek Pallati Sportit, ‘Arefi Berberi’
7. Policia Bashkiake dhe/ose Policia e Shtetit garantojnë zbatimin e përcaktimeve të bëra në këtë Vendim, duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore nga vendet jashtë përcaktimeve të bëra në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij Vendimi.
8. Vendimi bëhet publik në faqen e internetit të Bashkisë menjëherë pas miratimit.
9. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETAR  
Ilir XHAKOLLI